



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 3 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Urdhrit të
Dytë Gojor të 7 nëntorit 2024**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 nëntor 2024, gjatë dëshmisë së W01453-shit ("dëshmitari"),¹ Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") kërkoi të pranohej si provë një fragment i një dokumenti të përdorur me dëshmitarin.² Pasi dëgjoi parashtrimet e palëve,³ Trupi Gjykses e shënoi dokumentin për identifikim si 1D00204 ("dokumenti 1D00204 MFI").⁴
2. Më 7 nëntor 2024, Trupi Gjykses lëshoi urdhër gojor për mospranimin e dokumentit 1D00204 MFI si provë ("Vendimi i Kundërshtuar").⁵
3. Më 14 nëntor 2024, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi kërkesë për leje për apelim të Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").⁶
4. Më 21 nëntor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi përgjigje ndaj Kërkesës ("Përgjigja").⁷

¹ *Shih* transkriptet e seancave, 4-7 nëntor 2024.

² Transkripti i seancës, 6 nëntor 2024, f. 22100, rreshti 7 deri në f. 22101, rreshti 13, *që i referohet* DHT00177-DHT00492, f. DHT00403 (para. 580).

³ Transkripti i seancës, 6 nëntor 2024, f. 22102, rreshtat 2-22.

⁴ Transkripti i seancës, 6 nëntor 2024, f. 22102, rreshtat 23 deri në f. 22103, rreshti 3.

⁵ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2024, f. 22153, rreshti 21 deri në f. 22154, rreshti 9.

⁶ F02719, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Urdhrit të Dytë Gojor të 7 nëntorit 2024*, 14 nëntor 2024.

⁷ F02742, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Urdhrit të Dytë Gojor të 7 nëntorit 2024 (F02719)*, 21 nëntor 2024.

5. Më 25 nëntor 2024, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigja”).⁸

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja e Thaçit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar në lidhje me tre pikat e mëposhtme (bashkërisht, “pikat”):

- 1) Nëse Trupi Gjykses gaboi kur arriti në përfundimin se vlerësimi vizual i sjelljes së W01453-shit në sallën e gjyqit nga ana e Dhomës Gjyqësore së TPNJ-së në çështjen *Limaj*, nuk mund ta ndihmojë Trupin Gjykses (“pika e parë”);
- 2) Nëse Trupi Gjykses gaboi që nuk shpjegoi pse dokumenti 1D00204 MFI është i papranueshëm sipas rregullës 138 (“pika e dytë”); dhe
- 3) Nëse Trupi Gjykses gaboi që nuk konstatoi se janë përmbushur kriteret për pranimin e dokumentit 1D00204 MFI sipas rregullës 138 (“pika e tretë”).⁹

7. Mbrojtja parashton se pikat në fjalë përmbushin kriteret për leje për apelim, pasi: (i) burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk janë thjesht mospajtime me të;¹⁰ (ii) ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;¹¹ dhe (iii) kërkojnë vendim të menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit për t’i kontribuar thelbësisht procesit gjyqësor.¹²

8. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të rrëzohet pasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara në Ligj dhe në Rregullore.¹³ Në veçanti, ZPS-ja argumenton se pikat nuk janë të apelueshme pasi janë thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar, shtrembërojnë atë dhe shpërfillin konstatimet e mëparshme të Trupit Gjykses.¹⁴

⁸ F02748, Mbrojtja, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Urdhrit të Dytë Gojor të 7 nëntorit 2024 (F02719)*, 25 nëntor 2024. Trupi Gjykses vëren se Kundërpërgjigja u shpërnda më 26 nëntor 2024.

⁹ Kërkesa, para. 2. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 1, 24.

¹⁰ Kërkesa, para. 7-18.

¹¹ Kërkesa, para. 7, 19-20.

¹² Kërkesa, para. 7, 21-22.

¹³ Përgjigja, para. 1, 9.

¹⁴ Përgjigja, para. 1, 3-6.

Gjithashtu, ZPS-ja argumenton se Mbrojtja nuk arrin të demonstrojë se: (i) pikat do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo në rezultatin e gjykimit; dhe se (ii) një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit do t'i kontribuonte thelbësisht procesit gjyqësor.¹⁵

9. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se Kërkesa duhet të miratohet sepse Përgjigjja shtrembëron Kërkesën dhe nuk trajton argumentet që ngrihen aty.¹⁶

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Në bazë të nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse përmbushet standardi për miratimin e lejes për apel i përcaktuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

11. Trupi Gjykues përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse për standardin ligjor të miratimit të lejes për apel përcaktuar në vendime të mëparshme.¹⁷

¹⁵ Përgjigjja, para. 7-8.

¹⁶ Kundërpërgjigjja, para. 1. *Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen, para. 2-5.*

¹⁷ *Shih* F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të Urdhrit F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. *Shih gjithashtu* F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

IV. DISKUTIM

12. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses nuk pranoi si provë dokumentin 1D00204 MFI - një fragment nga aktgjykimi i shqiptuar në çështjen *Limaj dhe të tjerët* para Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (përkatësisht, "TPNJ" dhe "Aktgjykimi *Limaj*"). Dokumenti 1D00204 MFI përmban, në veçanti, vlerësimin e Dhomës Gjyqësore të TPNJ-së për sjelljen e W01453-shit në sallë të gjyqit dhe besueshmërinë e tij si dëshmitar në çështjen *Limaj dhe të tjerët* ("dëshmia në çështjen *Limaj*").¹⁸

13. Më konkretisht, në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se: (i) përgjegjësinë për të vlerësuar besueshmërinë e një dëshmitari dhe sa mund të mbështetesh në dëshminë e tij e ka ekskluzivisht Trupit Gjykses, dhe vlerësimin e sjelljes që mund të jetë relevante në kuadër të atij vlerësimi do ta bëjë Trupi Gjykses, jo një gjykatë tjetër; (ii) pjesët përkatëse të Aktgjykimit *Limaj* iu treguan dëshmitarit, i cili i komentoi ato gjatë marrjes në pyetje nga Mbrojtja; dhe se (iii) Trupi Gjykses nuk është i detyruar t'u përmbahet konstatimeve mbi provat, të bëra nga dhoma gjyqësore të tjera.¹⁹

14. Fillimisht, Trupi Gjykses rikujton se gjyksesit e fakteve gëzojnë kompetencë të konsiderueshme diskrecionale në marrjen e vendimit për pranimin ose mospranimin e provave, dhe se leje për apelimin e vendimeve mbi pranueshmërinë miratohet vetëm në raste të jashtëzakonshme.²⁰ Këto parime pasqyrohen në vlerësimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se "ndërhyrja e apelit për

¹⁸ 1D00204 MFI, para. 580.

¹⁹ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2024, f. 22153, rreshti 23 deri në f. 22154, rreshti 8.

²⁰ F02241, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialit P1046*, 15 prill 2024, para. 10; F02157, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit për Pranimin e Materialeve P959 dhe P960* ("Vendimi i 29 Shkurtit 2024"), 29 shkurt 2024, para. 11 dhe poshtëshënimi 26 (me referenca të mëtejshme). Shih gjithashtu ICTR, *Nyiramasuhuko v. Prosecutor*, ICTR-98-42-AR73.2, Appeals Chamber, [*Decision on Pauline Nyiramasuhuko's Appeal on the Admissibility of Evidence*](#), 4 October 2004, para. 5.

vendimet në lidhje me pranimin e provave për ligjet vetëm në rrethana shumë të kufizuara.”²¹

A. PIKA E PARË

15. Mbrojtja e Thaçit parashtroi se Trupi Gjyqësor gaboi kur konstatoi se vlerësimi vizual i sjelljes së W01453-shit që bëri Dhoma Gjyqësore e TPNJ-së në dokumentin 1D00204 MFI, nuk mund ta ndihmojë Trupin Gjyqësor, meqenëse: (i) ka shqetësime të arsyeshme dhe të mirëbazuara lidhur me mbështetshmërinë në dëshminë në çështjen *Limaj*, të cilën ZPS-ja e ka paraqitur si provë edhe në formën e audio dhe videoincizimeve; dhe (ii) Trupi Gjyqësor nuk është në pozitë të bëjë vlerësimin vizual të kësaj dëshmie, pasi incizimet përkatëse janë me dobi të kufizuar.²²

16. ZPS-ja përgjigjet se pika e parë shpërfill dokumentacionin e çështjes dhe nuk identifikon ndonjë gabim konkret në Vendimin e Kundërshtuar.²³ ZPS-ja gjithashtu argumenton se Trupi Gjyqësor do të mund ta vlerësojë si duhet sjelljen dhe besueshmërinë e W01453-shit mbi bazën e dëshmisë së tij në çështjen gjyqësore aktuale dhe incizimeve të dëshmisë në çështjen *Limaj* që i ka paraqitur si provë.²⁴

17. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se, megjithëse pjesa përkatëse e dokumentit 1D00204 MFI u lexua në transkriptin e seancës, pranimi i tij si provë thelbësore do të garantonte se Trupi Gjyqësor mund të mbështetet në të gjatë kuvendimeve të veta.²⁵ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit përsërit se audio dhe

²¹ KSC-CA-2022-01, F00114, Gjykata e Apelit, *Aktgjykimi i Apelit*, 2 shkurt 2023, para. 35. *Shih gjithashtu* Vendimin e 29 Shkurtit 2024, para. 11; ICTY, *Prosecutor v. Delalić et al.*, IT-96-21-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 20 February 2001, para. 533.

²² Kërkesa, para. 8-10, që i referohet F02708, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëhershme të W01453-shit sipas Rregullës 143(2)(c)*, 11 nëntor 2024, me Shtojcën 1.

²³ Përgjigja, para. 4.

²⁴ Përgjigja, para. 4.

²⁵ Kundërpërgjigja, para. 2.

videoincizimet e dëshmisë në çështjen *Limaj* janë me dobi të kufizuar për vlerësimin e sjelljes së W01453-shit prej Trupit Gjykses.²⁶

18. Së pari, Trupi Gjykses vëren se pika e parë thjesht përsërit parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit të bëra para Vendimit të Kundërshtuar. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja e Thaçit konkretisht u shpreh se dokumenti 1D00204 MFI duhet të pranohet pasi përmban një element faktik që Trupi Gjykses nuk e disponon ndryshe, përkatësisht vlerësimin e Dhomës Gjyqsore të TPNJ-së për sjelljen e W01453-shit gjatë dëshmisë në çështjen *Limaj*, të paraqitur si provë.²⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i kishte këto parashtrime kur lëshoi Vendimin e Kundërshtuar, dhe aty i shqyrtoi, trajtoi dhe rrëzoi ato. Në veçanti, në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses nuk konstatoi se informacioni që është pjesë e dokumentacionit të çështjes nuk e ndihmon aspak. Përkundrazi, Trupi Gjykses bëri konstatime në përputhje me vendimet e tij të mëparshme²⁸ lidhur me nëse pranimi i dokumentit 1D00204 MFI si provë do ta ndihmonte, dhe në çfarë mënyre mund ta ndihmonte Trupin Gjykses në rrethanat konkrete të çështjes. Në fakt, Trupi Gjykses shprehimisht: (i) përsëriti përgjegjësinë për të kryer vlerësimin e vet të besueshmërisë dhe natyrën jodetyruese të konstatimeve të këtij lloji të gjykatave të tjera;²⁹ dhe (ii) ritheksoi se dokumenti 1D00204 MFI iu lexua dëshmitarit fjalë për fjalë,³⁰ se dëshmitari e komentoi atë,³¹ dhe se për rrjedhojë, dhe në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit,³² thelbi i dokumentit

²⁶ Kundërpërgjigjja, para. 3. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 4.

²⁷ Transkripti i seancës, 6 nëntor 2024, f. 22102, rreshtat 4-8. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 8.

²⁸ F02013, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Tretë të Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155* ("Vendimi i Tretë sipas Rregullës 155"), 15 nëntor 2023, para. 50; F01603, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 155* ("Vendimi i Parë sipas Rregullës 155"), 14 qershor 2023, konfidencial, para. 49 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 8 shtator 2023, F01603/RED).

²⁹ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2024, f. 22153, rreshti 23 deri në f. 22154, rreshti 2; f. 22154, rreshtat 6-7.

³⁰ Transkripti i seancës, 6 nëntor 2024, f. 22100, rreshtat 14-25.

³¹ Transkripti i seancës, 6 nëntor 2024, f. 22101, rreshtat 5-9.

³² Kundërpërgjigjja, para. 2.

tashmë ishte pjesë e dokumentacionit të çështjes.³³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se pika e parë shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar dhe është thjesht mospajtim me arsyetimin e Trupit Gjykses dhe rezultatin e tij.

19. Sa i përket dobisë së audio dhe videoincizimeve të dëshmisë në çështjen *Limaj* për vlerësimin që do të bëjë, Trupi Gjykses vëren se ato nuk janë pranuar si prova në këtë moment, e as në kohën kur u lëshua Vendimi i Kundërshtuar. Rrjedhimisht, çdo parashtrim në lidhje me këtë është thjesht spekulim dhe jorelevant për vendimin e Trupit Gjykses për mospranimin e dokumentit 1D00204 MFI, ku, siç u përmend më lart, Trupi Gjykses shqyrtoi të gjitha elementet relevante, përfshirë faktin se dokumenti 1D00204 MFI u lexua tërësisht në transkriptin e seancës dhe Trupi Gjykses mund të mbështetet në të gjatë kuvendimeve në fund të gjykimit dhe duke pasur parasysh tërësinë e provave.

20. Për më tepër, Trupi Gjykses gjykon se pika e parë nuk përmbush standardin e duhur të miratimit të lejes për apelim të vendimeve në lidhje me pranimin e provave,³⁴ veçanërisht duke pasur parasysh, sërish, se pjesa përkatëse e dokumentit 1D00204 MFI është tashmë pjesë e dokumentacionit të çështjes. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të vërtetojë se pika e parë buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

21. Për sa më sipër, kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2), nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e parë. Kërkesa për leje për apelimin e pikës së parë rrjedhimisht rrëzohet.

B. PIKA E DYTË

22. Mbrojtja e Thaçit pretendon se Trupi Gjykses gaboi që nuk dha arsyetim të mjaftueshëm në vendimin e vet, duke qenë se nuk iu referua kriterëve të

³³ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2024, f. 22154, rreshtat 3-5.

³⁴ *Shih më lart*, para. 14.

pranueshmërisë sipas rregullës 138(1) dhe nuk artikuloi pse dokumenti 1D00204 MFI nuk i përmbushte këto kritere.³⁵

23. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Thaçit nuk ka demonstruar se pika e dytë është e apelueshme, pasi thjesht nuk pajtohet me Vendimin e Kundërshtuar.³⁶ Në veçanti, ZPS-ja argumenton se Vendimi i Kundërshtuar: (i) është i arsyetuar dhe në përputhje me vendime të mëparshme të Trupit Gjykues lidhur me konstatimet e gjykatave të tjera në lidhje me besueshmërinë; dhe (ii) qartësisht shqyrtoi dhe rrëzoi argumentet e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me relevancën dhe vlerën provuese të dokumentit 1D00204 MFI.³⁷

24. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se nuk kërkon pranimin si provë të një konstatimi të një gjykate tjetër në lidhje me besueshmërinë, por të provave për sjelljen e W01453-shit gjatë dhënies së deklaratave të mëparshme.³⁸

25. Trupi Gjykues është i mendimit se, megjithëse rregulla 138 nuk përmendet shprehimisht në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykues nuk pranoi dokumentin 1D00204 MFI si provë për shkak të faktorëve paraprakë për vlerësimin e kritereve të rregullës 138(1), përkatësisht: (i) përgjegjësisë ekskluzive e këtij Trupi Gjykues për të vlerësuar besueshmërinë dhe sjelljen e një dëshmitari;³⁹ dhe (ii) faktit se pjesa relevante e dokumentit është tashmë pjesë e dokumentacionit të çështjes pavarësisht nga natyra e saj,⁴⁰ dhe rrjedhimisht e disponueshme për Trupin Gjykues nëse do ta vlerësojë të arsyeshme të mbështetet në të në fund të gjykimit, duke pasur parasysh tërësinë e provave. Trupi Gjykues thekson se nuk e pranoi dokumentin 1D00204 në bazë të këtyre faktorëve paraprakë, dhe, për më tepër, në përputhje me vendimet e tij të mëparshme në

³⁵ Kërkesa, para. 11-14.

³⁶ Përgjigja, para. 5.

³⁷ Përgjigja, para. 5.

³⁸ Kundërpërgjigja, para. 5.

³⁹ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2024, f. 22153, rreshti 23 deri në f. 22154, rreshti 2; f. 22154, rreshtat 6-7.

⁴⁰ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2024, f. 22154, rreshtat 3-5.

lidhje me: (i) përgjegjësinë ekskluzive të Trupit Gjykses për vlerësimin e sjelljes së një dëshmitari dhe/ose mbështetshmërisë në dëshminë e atij dëshmitari, si edhe mbështetjen në vlerësimet e bëra nga gjykata të tjera të llojit si dokumenti 1D00204 MFI;⁴¹ dhe (ii) vlerësimin e vetë Trupit Gjykses lidhur me mbështetshmërinë në dëshmitë e dëshmitarëve dhe mospërputhjet e mundshme ndërmjet deklaratave të tyre, të cilin e bën mbi bazën e të gjitha provave të pranuar gjatë gjykimit.⁴² Për këto arsye, Trupi Gjykses gjykon se pika e dytë shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar dhe është thjesht mospajtim me të dhe veçanërisht me rezultatin e shqyrtimit prej Trupit Gjykses të të gjitha elementeve relevante.

26. Për më tepër, Trupi Gjykses vlerëson se pika e dytë nuk përmbush standardin e duhur të miratimit të lejes për apelim të vendimeve në lidhje me pranimin e provave,⁴³ veçanërisht duke pasur parasysh, sërish, se pjesa përkatëse e dokumentit 1D00204 MFI është tashmë pjesë e dokumentacionit të çështjes. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të vërtetojë se pika e dytë buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

27. Për sa më sipër, kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2), nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e dytë. Kërkesa për leje për apelimin e pikës së dytë rrjedhimisht rrëzohet.

⁴¹ *Shih* Vendimin e Tretë sipas Rregullës 155, para. 50; Vendimin e Parë sipas Rregullës 155, para. 49.

⁴² *Shih, p.sh.,* Vendimin e Parë sipas Rregullës 155, para. 50. *Shih gjithashtu* F02328, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W01511, W04260, W04305, W04410, W04744, W04752 dhe W04764 sipas Rregullës 154 (F02204), 22 maj 2024, konfidencial, para. 89 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02328/RED); F01976, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të* W00498-ës, W01140-s dhe W01763-shit sipas Rregullës 154, 1 dhjetor 2023, konfidencial, para. 21 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F01976/RED).

⁴³ *Shih më lart*, para. 14.

C. PIKA E TRETË

28. Mbrojtja e Thaçit parashtroi se Trupi Gjykses gaboi kur konstatoi se dokumenti 1D00204 MFI nuk përmbushte kriteret e pranueshmërisë sipas rregullës 138(1),⁴⁴ dhe se ky konstatim gjithashtu: (i) nuk përputhet me vendimet e mëparshme të Trupit Gjykses;⁴⁵ dhe (ii) dëmton Mbrojtjen, pasi ZPS-ja bazohet në dëshminë në çështjen *Limaj* për vërtetësinë e përmbajtjes së saj.⁴⁶

29. ZPS-ja përgjigjet se pika e tretë në thelb është riformulim i pikës së parë dhe përbën thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar.⁴⁷ ZPS-ja gjithashtu argumenton se: (i) mospranimi i dokumentit 1D00204 MFI që tashmë është pjesë e dokumentacionit të çështjes, nuk do të shkaktonte asnjë dëm; dhe (ii) pika e tretë shpërfill konstatimet e mëparshme të Trupit Gjykses.⁴⁸

30. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se nuk kërkon pranimin e një konstatimi të një gjykate tjetër në lidhje me besueshmërinë, por të provave për sjelljen e W01453-shit gjatë dhënies së deklaratave të mëparshme.⁴⁹

31. Trupi Gjykses është i mendimit se faktorë të ngjashëm si ato përmendur më lart lidhur me pikën e dytë, vlejnë edhe për pikën e tretë.⁵⁰ Në veçanti, duke qenë se konstatimet e Trupit Gjykses në Vendimin e Kundërshtuar u bazuan në faktorë paraprakë në lidhje me standardin e pranueshmërisë sipas rregullës 138(1) që janë në përputhje me vendime të mëparshme të Trupit Gjykses, Trupi Gjykses është i mendimit se pika e tretë shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar kur pretendon se Trupi Gjykses zbatoi gabimisht këtë rregull. Për të njëjtat arsye, Trupi Gjykses

⁴⁴ Kërkesa, para. 15.

⁴⁵ Kërkesa, para. 16, që i referohet F01733/RED, Trupi Gjykses, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Materiale që Lidhen me Dëshminë e [REDAKTUAR], 1 nëntor 2023), para. 14 (versioni konfidencial u dorëzua më 23 gusht 2023, F01733).

⁴⁶ Kërkesa, para. 17.

⁴⁷ Përgjigja, para. 6.

⁴⁸ Përgjigja, para. 6.

⁴⁹ Kundërpërgjigja, para. 5.

⁵⁰ *Shih më lart*, para. 22-25.

vlerëson se parashtrimet e palëve mbi relevancën, vlerën provuese dhe dëmin,⁵¹ nuk kanë të bëjnë me pikën në fjalë dhe nuk ka nevojë të trajtohen. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se Mbrojtja keqkupton Vendimin e Kundërshtuar dhe shpreh thjesht mospajtim me konstatimet e tij.

32. Gjithashtu, Trupi Gjykses vlerëson se pika e tretë nuk përmbush standardin e duhur të miratimit të lejes për apelim të vendimeve në lidhje me pranimin e provave,⁵² veçanërisht duke pasur parasysh, sërish, se pjesa përkatëse e dokumentit 1D00204 MFI është tashmë pjesë e dokumentacionit të çështjes. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të vërtetojë se pika e tretë buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

33. Për sa më sipër, kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2), nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e tretë. Kërkesa për leje për apelimin e pikës së tretë rrjedhimisht rrëzohet.

V. VENDIM

34. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses **RRËZON** Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 3 dhjetor 2024

Në Hagë, Holandë.

⁵¹ Kërkesa, para. 16-17; Përgjigjja, para. 5-6; Kundërpërgjigjja, para. 5.

⁵² *Shih më lart*, para. 14.